



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQSOR
TIRANE

NR. 4775 AKTI

NR. 2128 VENDIMI

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane, e përbëre prej:

Gjyqtarit: ARBEN MICKO

Asistuar prej sekretares **Enkeleda Luga**, pas shqyrtimit ne seance gjyqësore me dyer te hapura, sot me datë **26.03.2007**, - jep kete:

V E N D I M

Për çështjen civile me Nr. 4775 Akti dhe date regjistrimi 21.03.2007, e që i përket:

KËRKUESE : **Mimoza Pashko**– e bija e Pëllumbit dhe e Fatimes, e dtl. 16.05.1954, lindur në Tiranë dhe banuese në Tiranë, Rr"Derwish Hima" e ve, me shtetësi dhe kombësi shqiptare, përfaqësuar në gjykim nga Av. Gerhard Velaj dhe Av. Valbona Gjonçari, me prokurë të posaçme nr. 617 rep, nr. 147/3 kol, dt. 24.01.2007.

OBJEKTI: Lëshim i dëshmise se trashëgimise ligjore për Trashëgimlënësit Gramos Pashko dhe Ruben Pashko.

Baza Ligjore: Nenet 348 e vijues të K.Civil.

Në bazë të nenit 59 të K.Pr.Civile, gjykata shqyrtoi kryesisht nëse çështja bën pjesë në juridiksionin gjyqësor civil dhe në bazë të neneve 59 e 36 të këtij kodi u konkludua se kjo çështje bën pjesë në juridiksionin gjyqësor civil.

Në bazë të nenit 158/a dhe 61 të K.Pr.Civile, gjykata shqyrtoi kryesisht kompetencën e saj, dhe në bazë të neneve 61, 41 e 388 të këtij kodi u konkludua se kërkesa është në kompetencën e saj si nga pikpa
lëndore ashtu dhe tokësore.

Në bazë të nenit 35/1 të K. Pr. Civile gjykimi u bë nga një gjykatës.

Në përfundim të gjykimit të zhvilluar në prani të përfaqësuesve të kërkueses, gjykata si dëgjoi përfaqësuesit e kërkueses, të cilët kërkuan pranimin e kërkesës, dhe pasi shqyrtoi aktet e bisedoi çështjen;

V Ë R E N

Se kerkuesja Mimoza Pashko, më datë 21.03.2007, ka depozituar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, një kërkesë me anë të së cilës kërkohet "*Lëshimi i dëshmisë së trashëgimisë ligjore për trashëgimlënësit Gramos Pashko dhe Ruben Pashko*".

Nga provat shkresore (certifikata vdekje, familjare dhe personale - administruar ne gjykim) si dhe shpjegimet e përfaqësuesesve të kërkueses, rezultoi e provuar se : Trashëgimlënësi Gramos Pashko ka qënë i martuar me Mimoza Pashkon. Nga martesat e tyre kanë pasur dy fëmijë Flonia Pashko e datëlindjes 11.05.1977 dhe Ruben Pashko i datëlindjes 19.03.1982.

Trashëgimlënësi Gramos Pashko dhe djali i tij Ruben Pashko kanë vdekur aksidentalisht në dt. 16.07.2006. Me vendimin Nr. 800, dt. 09.02.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është vendosur çregjistrimi nga regjistrat e gjëndjes civile dhe regjistrimin si të vdekur të të ndjerëve Gramos Pashko dhe Ruben Pashko.

Trashëgimlënësi nuk rezulton të ketë pasur fëmijë të birësuar apo të lindur jashtë martese. Nuk rezulton të ketë lënë testament. Trashëgimlënësia Flonia Pashko (e bija) nëpërmjet deklaratës noteriale të dt. 22.02.2007 bërë para noterit ka hequr dorë nga trashëgimia si trashëgimtare e trashëgimlënësit Gramos Pashko.

Nga çmuarja e faktit që rezulton si më sipër dhe interpretimi i dispozitave ligjore, nga ana e gjykatës konkludohet se:

Së pari - Lidhur me dëshminë e trashëgimisë për të ndjerin Gramos Pashko, si ligj rregullues do të jetë K.Civil në fuqi, pasi data e vdekjes së tij është 16.07.2006, e që përkon me kohën kur është në fuqi ky ligj rregullues (shih nenin 318 të K.Civil, 1994).

Meqënëse ky trashëgimlënës nuk ka lënë testament, do të zbatohet rregullimi i trashëgimisë ligjore në lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë (shih nenin 317 të K.Civil, 1994).

Si trashëgimtarë ligjorë të tij do të thirren: *bashkeshortja* Mimoza Pashko.

Të sipërcituarit hyjne ne trashëgim si trashëgimtarë ligjorë të radhës së parë (shih nenet 320, 360, 361 dhe 369 të K.Civil, 1994).

Pjesa takuese e secilit do të jete si me poshte:

- Mimoza Pashko (*bashkëshortja*), e cila trashëgon e vetme të gjithë pasurinë.

Se dyti - Lidhur me dëshminë e trashëgimisë për të ndjerin Ruben Pashko, si ligj rregullues do të jetë K.Civil në fuqi - pasi data e vdekjes së tij është 16.07.2006, e që përkon me kohën kur është në fuqi ky ligj rregullues (shih nenin 318 të K.Civil, 1994).

Meqënëse, edhe kjo trashëgimlënës nuk ka lënë testament, nuk ka qënë i martuar, nuk ka pasur fëmijë do të zbatohet rregullimi i trashëgimisë ligjore në lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë (shih nenin 317 të K.Civil, 1994).

Si trashëgimtare ligjore të tij të radhës së dytë do të thirren: Mimoza Pashko, pasi këta bëjnë pjesë në rrethin e trashëgimtarëve ligjorë të rradhës së dytë dhe rezultojnë gjallë në kohën e çeljes së trashëgimisë, pasi nuk ka të bëjë pjesë në rrethin e trashëgimtarëve ligjorë të radhës së parë. Pjesa takuese e saj do të jetë e tërë pasuria .

Për çka dhe si u arsyetua më sipër,

kjo gjykatë duke u bazuar edhe në:

Nenet: 317, 318, 320, 348, 360, 361 dhe 369 të K.Civil, 1994

Nenet: 306, 309, 310 dhe 388 të K.Pr.Civile

V E N D O S I

- Pranimin e kërkesës së kërkueses Mimoza Pashko.
- 1- Lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore për trashëgimlënësin Gramos Pashko.
- Njohjen si trashëgimtarë ligjorë të tij të radhës së parë:
 - Mimoza Pashko (*bashkëshortja*), e cila trashëgon e vetme të gjithë pasurinë trashëgimore të trashëgimlënësit si dhe detyrimet që rrjedhin nga kjo pasuri.
- 2- Lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore për trashëgimlënësin Ruben Pashko.

- Njohjen si trashëgimtarë ligjorë të tij të radhës së dytë:
 - Mimoza Pashko (e ëma), e cila trashëgon e vetme të gjithë pasurinë trashëgimore të trashëgimlënësit si dhe detyrimet që rrjedhin nga kjo pasuri.
- Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të kërkuësit.
- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, brenda 15 diteve nga e nesërmya e shpalljes.
- U shpall sot në Tiranë, më datë 26.03.2007.

SEKRETARE
ENKELEDA LUGA

Edna

REPUBLICA E SHQIPERISE
GJYKATA E APELIT
TIRANE
TARRHEN MICKO

SHPENZIMET GJYQËSORE

1. Taksë regjistrimi 100 Lekë

VERTETËJHET SE KY VENDIM
MORI FORME TE PRERË ME DT
TIRANE 10.04.2007
16.04.2007 JK/SEKRETARE
MIMOZA LULAJ

JK

REPUBLICA E SHQIPERISE
GJYKATA E APELIT
TIRANE
KANCELARI
LIR SAULI

JK